



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 818 Prot.

Tiranë, më 07.06 2019

VENDIM Nr. 137, datë 28.05.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 48 Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 6, datë 28.05.2019, pasi shqyrtoi kërkesën me objekt *"Projekti për ndërhyrje rehabilituese dhe konservuese në parkun arkeologjik të Amantias"* paraqitur nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë, Sektori i Menaxhimit të Parqeve Amantia-Orik-Finiq.

VENDOSI:

1. Të miratojë *"Projektin për ndërhyrje rehabilituese dhe konservuese në parkun arkeologjik të Amantias"* paraqitur nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë, Sektori i Menaxhimit të Parqeve Amantia-Orik-Finiq.
2. Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë, Sektori i Menaxhimit të Parqeve Amantia-Orik-Finiq, të njoftojë fillimin e punimeve të ndërhyrjeve rehabilituese dhe konservuese duke përfshirë në to edhe studentët shqiptarë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**